

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**EDUKIMI FINANCIAR SI NXITËS I KËRKESËS PËR SHËRBIME FINANCIARE NË**  
**TREGJET FINANCIARE JOBANKARE**

**M.Sc. Arta Sinamati<sup>1</sup>**  
**Ed.D. Ariana Çela<sup>2</sup>**

***Abstrakt***

Niveli i kulturës dhe edukimit financiar të konsumatorëve dhe i publikut në tërësi, prej vitesh ka tërhequr vëmendjen e institucioneve të një numri vendesh gjithnjë e në rritje. Zhvillimi financiar është kritik për rritjen ekonomike, por mikropërcaktuesit e tij ende nuk kuptohen mirë. Duhet pasur parasysh që edukimi financiar nuk është vetëm për investitorët dhe se për ngritjen e zhvillimin sa më të ekuilibruar të një sistemi financiar shumëfunksional, një edukim i mirë i popullatës luan rol kyç.

Në literaturë argumentohet se edukimi financiar i pamjaftueshëm përbën një pengesë të rëndësishme për kërkesën për shërbime financiare: nëse individët nuk i njohin apo kuptojnë produktet, nuk i kërkojnë ato. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e njohurive financiare në përdorimin e shërbimeve financiare jobankare në Shqipëri. Një analizë e regresionit logjistik zbatohet për të vlerësuar përdorimin e shërbimeve financiare në bazë të nivelit të edukimit financiar të individit, sipas modelit të *Gan et al.* (2006). Edukimi financiar vlerësohet përmes disa nënvariablave të tilla si vlera në kohë e parasë, interesi dhe principali, diversifikimi, risku e inflacioni. Disa variabla të tjerë përfshihen në ekuacion për të shpjeguar përdorimin e shërbimeve financiare, të tilla si mosha, gjinia, statusi ekonomik, perceptimet ndaj tregut, etj. Për qëllimet e këtij studimi përdoren të dhëna primare të mbledhura nga individë përmes një pyetësoi në qytetin e Tiranës.

Rezultatet e analizës pritet të konfirmojnë se edukimi financiar ndikon në përdorimin e shërbimeve financiare. Në fund, diskutohen disa rekomandime në vëmendje të politikbërësve për të rritur nivelin e njohurive financiare, në funksion të përdorimit të produkteve të nevojshme financiare jobankare.

***Fjalë kyçe:*** *edukim financiar, përdorim i shërbimeve financiare, produkt financiar, Shqipëri*

---

<sup>1</sup> University of New York Tirana, [artasinamati@unyt.edu.al](mailto:artasinamati@unyt.edu.al)

<sup>2</sup> University of New York Tirana, [arianacela@unyt.edu.al](mailto:arianacela@unyt.edu.al)